

KËRKESË
Nr. 102, datë 31.5.2023

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR INDIVIDËT E INTERESUAR PËR T’U
LICENCUAR SI ADMINISTRATOR FALIMENTIMI**

Në zbatim të nenit 203, të ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016, “Për falimentimin”; të nenit 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 294, datë 17.5.2023, “Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave, për paraqitjen e kërkesave, për të vepruar si administrator në procedurat e falimentimit, si dhe për procedurën për dhënien e heqjen e licencës”, publikohet kjo thirrje në faqet zyrtare *web* të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit, Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Pas përfundimit të afatit 15-ditor të këtij publikimi, individët e interesuar për t’u licencuar si administrator falimentimi paraqesin kërkesat e tyre me dokumentacionin shoqërues, duke i dorëzuar ato në portalin *e-Albania*, në linkun:

https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9429, brenda një afati 15-ditor sipas parashikimeve të nenit 5, pika 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 294, datë 17.5.2023, “Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave, për paraqitjen e kërkesave, për të vepruar si administrator në procedurat e falimentimit, si dhe për procedurën për dhënien e heqjen e licencës”.

Tarifa për pjesëmarrje në provimin e kualifikimit është 10 000 (dhjetë mijë) lekë dhe paguhet në llogarinë bankare të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit, pas publikimit të listës përfundimtare të personave që kualifikohen për të marrë pjesë në provimin përfundimtar.